

VENDIM
Nr.614, datë 11.6.2009

**PËR PAGIMIN E SHPENZIMEVE PËR KTHIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË
TË KOKËS SË ZEUSIT-ASKLEPIUS, OBJEKT ARKEOLOGJIK ME VLERA
KOMBËTARE DHE UNIKALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6 2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 8 të ligjit nr. 10 025, datë 27.11.2008 “ Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të kryejë pagesën 2 700 000 (dy milionë e shtatëqind mijë) lekë, për mundësimin e kthimit në Republikën e Shqipërisë të kokës së Zeusit-Asklepius, objekt arkeologjik, me vlera kombëtare dhe unike, i grabitur nga Muzeu Arkeologjik i Butrintit në vitin 1991.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit. Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha